



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 39 Prot

Tiranë më, 05.01.2023

Nr. 1834 Dosje

URDHËR

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB – TIRANË)

Unë Altin Vako, me detyrën e Përmbaaruesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1002 (31134-02842-80-2022) Regj.Them, datë 19.05.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndrequr me Vendimin Nr. 77 (31135-03515-80-2022), datë 05.07.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1834, Datë 20.12.2022 kërkesën e kreditorit Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit I.K.M.T, ndaj debitorit Shoqërisë “CLASSIC” Sh.p.k., në lidhje me titullin ekzekutiv, Vendim për Dënim me Gjobë Nr. 333, datë 09.12.2021.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshem, duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 1482 Prot, Datë 21.12.2022 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhëri i ekzekutimit Nr. 1002 (31134-02842-80-2022) Regj.Them, datë 19.05.2022, ndrequr me Vendimin Nr. 77 (31135-03515-80-2022), datë 05.07.2022, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOJ

Se debitori Shoqëria “CLASSIC” Sh.p.k, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit, dhe nuk i është pergjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër duke vënë sekuestër mbi aksionet e debitorit Shoqërisë “CLASSIC” Sh.p.k dhe Z. Artan Harallamb Qesko (në cilësinë e administratorit të Shoqërisë “CLASSIC” Sh.p.k), në masen që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.



Për sa më sipër, në referim të Ligjit Nr. 26/2019, Datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat", Nenit 39 të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative",

URDHËROJ

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:
 - a) Shoqëria "CLASSIC" Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: J91909004J;

Dhe

 - b) Z. Artan Qesko (atëia: Harallamb, datëlindja: 04.07.1959);
(në cilësinë e administratorit të Shoqërisë "CLASSIC" Sh.p.k)
2. Pas vënies së masës së sekuestros, të informohemi në lidhje me:
 - a) adresën e ushtrimit të veprimtarisë private.
 - b) llojin e aktivitetit për të cilin është pajisur me licencë.
 - c) bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit.
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
4. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.
5. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në K.Pr.Civile, pala debitore mundet të paraqesë ankim para Gjykatës, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhëri
6. Ky urdhër përpilohet dhe mbahet në disa kopje.

PËRMBARUES GJYQËSOR

ALTIN VAKO

